



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:132186

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05478130

C.nr.62/2019

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh.K nga Rahoveci, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson S (G) Z nga Rahoveci, ndaj të paditurit R (Q) M nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, tani me adresë të vendbanimit të panjohur, me bazë juridike – kthimin e borxhit, me vlerën e objektit të kontestit prej 1,000.00 euro, jashtë seancës, më datën 20.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia e paditëses Sh.K nga Rahoveci, ndaj të paditurit R (Q) M nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, në çështjen juridike kontestimore, C.nr.62/2019.

Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësja Sh.K nga Rahoveci, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, në këtë gjykatë më datën 20.02.2019 ka parashtruar padinë ndaj të paditurit R (Q) M nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, tani me adresë të vendbanimit të panjohur, me bazë juridike – kthimin e borxhit, me vlerën e objektit të kontestit prej 1,000.00 euro.

Lidhur me këtë çështje kontestimore, kjo gjykatë të paditurit i ka dërguar aktvendimin me numër C.nr.62/2019 të datës 20.09.2023 për përgjigjen në padi në adresën e dhënë nga paditësja në, por e njëjta është kthyer me konstatimin e deklaruar nga prindi i të paditurit se i njëjti është shpërngulur në Gjermani.

Kjo gjykatë me aktvendimin me numër C.nr.62/2019 të datës 29.09.2023 e ka detyruar të paditurën që brenda afatit prej 15 ditëve ta plotësojë, ta precizojë padinë duke i rregulluar të dhënat gjeneralë të të paditurit, eventualisht të propozojë përfaqësues të përkohshëm, me pasuesin që do të konsiderohet e tërhequr padia nëse nuk vepron sipas këtij aktvendimi, ndërsa në qoftë se kthehet pa u korrigjuar gjegjësisht pa u plotësuar, do të hedhet poshtë padia. Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses me parashtrësën e datës 06.10.2023, e ka plotësuar padinë duke propozuar caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm. Pas kësaj, kjo gjykatë me aktvendimin e saj të datës 10.01.2024 e ka detyruar paditësen që në afatin prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, në llogarinë e kësaj gjykate të e deponojë shumën e të hollave prej 500.00

euro për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm dhe gjykatës t’ia prezantojë dëshminë e pagesës së kryer, duke e paralajmëruar se nëse nuk deponohet shuma e cekur, do të hedhet poshtë padia e paditëses.

Me dispozitën e nenit 79.3 pika a) te Ligjit te Procedurës Kontestimore shprehimisht thuhet “*gjykata do ti caktoj palës se paditur përfaqësuesin e përkohshëm, në qoftë se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë*”, kurse me dispozitën e nenit 81.1 të po të njëjtit ligj shprehimisht thuhet se, “*gjykata e cakton përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve*” ndërsa me dispozitën e paragrafit 2 te nenit 81 të po të njëjtit ligj shprehimisht thuhet “*në rastet nga paragrafi 2 i nenit 79 të këtij ligji i padituri ka për detyrë të deponoj shumën e të hollave për pagimin e shpenzimeve të përfaqësuesit të përkohshëm, kurse në rastet nga paragrafi 3 i të njëjti nen shpenzimet i deponon paditësi*”. Gjithashtu, neni 391 i LPK-së parasheh që “*Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: g) paditësi brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk i ka hequr mungesat nga neni 79 dhe 102 të këtij ligji*”.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi bazuar në nenin 79.3 pika a), 81.1 dhe 2, 391 pika g) dhe 142.2 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t’i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së pasi që secila palë paraprakisht vet i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.62/2019, më datën 20.03.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.